Emërtimi i Institucionit M. P. J.
Emërtimi i Sektorit Zurich.

# Dosja

**Nr** 774 **Viti** 1992.

**Titulli i dosjes** B.I/2

Xhon Megou – problemi për caktimin e Konsullit nderi të Shqipërisë në Zurich.

Afati i ruajtjes Pergjithmonë
Sasia e fletëve 5
K.16

Ka filluar më 8.9.1992
Ka mbaruar më 11.9.1992
Regjistruar në inventarin e dosjeve me numur rendor

1

DÉPARTEMENT FÉDÉRAL DES AFFAIRES ÉTRANGÈRES

p.B.23.22.Alb.
ad: Prot. No: 189/92

Le Département fédéral des affaires étrangères présente ses compliments à l'Ambassade de la République d'Albanie et, se référant aux notes que cette dernière a adressées à l'Ambassade de Suisse à Vienne les 21 juillet 1992 et 1er septembre 1992 relatives à la nomination de Monsieur **John McGough** comme **Consul honoraire d'Albanie en Suisse** a l'honneur de l'informer de ce qui suit:

1. Le Département suggère aux autorités albanaises, avant tout, de coordonner la nomination de Consul honoraire avec l'ouverture imminente de l'Ambassade de la République d'Albanie à Berne qui, selon les informations de Monsieur Thoma HAXHI, Chargé d'affaires a.i. en Suisse, sera chargée d'exercer des fonctions consulaires.

2. Au cas où la candidature de Monsieur John McGough sera retenue, il y aura lieu de soumettre au Département:

- Une demande formelle d'ouverture d'un poste consulaire (Consulat ou Consulat général), en mentionnant la circonscription consulaire (un ou plusieurs Cantons) et le lieu où le poste consulaire aura son siège (capitale cantonale)
- un curriculum vitae plus détaillé avec les adresses privée et professionnelle de Monsieur McGough
- en vue de la demande d'exequatur qui sera soumise au Conseil fédéral, les autorités albanaises établiront une lettre de provision au sens de l'article 11 de la Convention de Vienne sur les relations consulaires du 24 avril 1963.

Le Département saisit cette occasion pour renouveler à l'Ambassade l'assurance de sa haute considération.

Berne, le 8 septembre 1992

DÉPARTEMENT FÉDÉRAL DES AFFAIRES ÉTRANGÈRES

A l'Ambassade de la
République d'Albanie

BERNE

Departamenti federal i puneve te jashtme te Zvicres i referohet notes se ambasades sone ne Vjene derguar ambasades zvicerane ne Vjene me 21 korrik 1992 dhe 1 shtator 1992 lidhur me caktimin e z. John Mcgough si konsull nderi te Shqiperise ne Zvicer dhe parashtron keto kerkesa:

1-Departamenti ne fjale u sugjeron autoriteteve shqiptare qe te koordinojne emerimin e konsullit te nderit me hapjen iminente te ambasades shqiptare ne Vjene, e cila, sipas te ngarkuarit mepune, Thoma HAXHI, do te ngarkohet te ushtroje funksione konsullore.

2-Ne rastin se kandidatura e z. Mcgough do te ruhet, atehere duhet ti paraqitet Departamentit nje kerkese formale per hapjen e nje zyre konsullore (konsulate ose konsulate e pergjithshme), ku te permendet distrikti konsullor (nje ose shume kantone) dhe vendi ku zyra konsullore do te kete seline e saj (kryeqyteti kantonal).

-Nje curriculum vitae me te detajuar te me te dhena private dhe profesionale te z. Mcgough.

-Lidhur me kerkesen e ekzekutimit qe do ti paraqitet Keshillit Federal autoritetet shqiptare duhet te hartojne nje leter provizioni, sipas artikullit 11 te KOnventes se Vjenes per marredheniet konsullore te dates 24.03. 1963

te kërkohet përgjigj ... V.Y. 11.9.92

DREJTORIA E DYTE

Z. Minister

# INFORMACION

Me date 07.09.1992, i ngarkuari me pune i Ambasades se Zvicres ne Tirane, Kristian Hansuirth, ne aeroportin e Rinasit, bashke me zotin Gazmend Turdiu na ngriti keto probleme lidhur me Xhon Megoun.

1. Mendoj tha se Xhon Megou nuk duhet te dale ne Televizionin shqiptar duke dhene intervista per problemin e arit. Ky problem eshte midis dy vendeve tona. Shqiperia ka bere nje kerkese zyrtare per kete çeshtje, ne ju kemi ofruar dokumentacionin e nevojshem juridik lidhur me proceduren qe duhet ndjekur,( materialet i jane derguar komisionit te kontrollit te Shtetit). Nuk duhet te trajtohet çeshtja nga persona private.

2. Xhon Megout nuk i eshte miratuar nga qeveria zvicerane statusi i konsullit te nderit te Shqiperise ne Zvicer. Pa patur kete miratim ai nuk mund te paraqitet si i tille. Kuptohet, po nuk iu dha ky miratim nga qeveria zvicerane, nuk mund te beje asgje per Shqiperine e shqiptaret ne Zvicer se portat zyrtare do te jene te mbyllura per te.

( Zoti Minister, sipas bisedes qe beme, me date 8.9.1992 i drejtuam noten zyrtare ambasades zvicerane ketu qe te na jape nje pergjigje zyrtare lidhur me kerkesen e pales sone per te pranuar qytetarin zvicerан Xhon Megou si konsull nderi i Shqiperise ne Zvicer).

Llesh Kola

Tirane,me 9.9.1992

11.9.92

Zoto Ministr
11. P. 1992.

DREJTORIA E DYTE

# INFORMACION

1. Ne darken e mbremshme qe dha i ngarkuari me pune i Ambasades se Zvicres per vajtjen e ambasadorit tone ne Zvicer, ai ne vazhdim te bisedes para tre ditesh ne aeroport lidhur me Xhon Megoun, tha se pergjigja jone eshte negative per te. Kerkoi qe ne te terheqim kerkesen meqe qenia e tij si konsull nderi, me hapjen e Ambasades sone ne Berne, nuk justifikohet. I thashe se kemi bere tashme kerkesen zyrtare prane jush dhee riperseritem. Ne nuk kemi perse e terheqim ate kerkese, Qeveria juaj ne baze te kerkeses sone te na jape nje pergjigje zyrtare me shkrim dhe pastaj do ta shohim çeshtjen Megou per me vone. Ra dakord. Foli per pakenaqesite e tij ndaj personit. Tha se kur kishte vajtur tek presidenti per takim ai ishte ne krahun e tij. Nuk me erdhi mire per kete fakt. Nje person privat nderhyn ne punet zyrtare. Ai prish pune dhe nuk zgjidh. Te hyje dhe te dale nga Shqiperia vetem si biznesmen pajisjesh mjekesore qe eshte jo me teper mendoj une. Megou i kishte thene se do te kete edhe pasaporte diplomatike shqiptare. Ja pergenjeshtrova si te pavertete. Tha se mendoj, se qendrimi qe vihet re ndaj Megout nuk duhet te jete qendrimi juaj zyrtar se nuk i kerkohet apo sugjerohet nga ju per te dale ne TV etj. Pergjigja ishte se deri tani Xhon Megou eshte dhe konsiderohet si mik i Shqiperise dhe jo me teper. TV-ja eshte i pavarur dhe nuk i imponohemi se kur dhe kujt duhet t'i marre intervista.

2. Lidhur me dergimin para pak kohesh te nje grupi stazieresh bujqesore ( 15 veta) ne Zvicer tha se perzgjedhja e tyre nuk eshte bere e mire. Kane dale shume probleme me ta. Nje person do te

kthehet, kater te tjere kane krijuar probleme serioze me fermeret dhe keta te fundit jane shprehur se nuk do te presin me shqiptare per punesim. Kjo nuk eshte ne te miren tuaj. Nga perzgjedhja e elementeve varet dhe imazhi i vendit tuaj. Kerkoi qe per here te tjera ai t'i shohe vete personat siç veproi me specialistet e Ministrise sone dhe bashkepunimi per kete problem ta kete vetem me ne si Ministri e Jashtme. Çdo gje tha ai tani e tutje do ta bej me ju dhe kerkoj qe te me perkrahni. Tha se ishte i kenaqur nga niveli i kursantave qe perzgjodhen ne [illegible] si Ministri.

Siç e dini ne darke ishte dhe zoti Tanush Çabej.

Llesh Kola

LlKola

Tirane,me 11.9.1992